



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2021:100041
Datë: 17.06.2021
Numri i dokumentit: 01896234

PPP.nr.25/2021

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, si përmbarimore e përberë nga Gjyqtari individual Blerim Istrefi, ne çështjen juridike të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave AMBIENTI SH.A, Njësia Operative Istog, kundër debitorit Sh. (V.) B. nga Fsh. T. Komuna e Istogut, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 407.60 €, duke vendosur sipas prapësimit te parashtruar nga ana e debitori me dt. 11.05.2021, kundër Urdhrit mbi Lejimin e Përmbarimit, jashtë seancës me datën 17.06.2021, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET PJESËRISHT prapësimi i debitorit Sh. (V.) B. nga Fsh. T. Komuna e Istogut, ashtu që:

II.SHFUQIZOHET PJESËRISHT Urdhri mbi Lejimin e Përmbarimit P.nr.114/2021, i dt: 20.04.2021, për periudhën kohore 01.06.2011 e gjerë më 31.12.2019 në shumë prej 341.80 € dhe **OBLIGOHET** debitori Sh. (V.) B. nga Fsh. T. Komuna e Istogu, që kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave AMBIENTI SH.A, Njësia Operative Istog, në emër të borxhit për bartjen e mbeturinave për periudhën kohore 27.01.2020 e gjer me 28.02.2021, t'ia paguaje shume prej 65.80 €, të gjitha këto ne afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimit, nën kërcënim të përmbarimit te detyrueshëm.

A r s y e t i m

Kreditori, Kompania Rajonale e Mbeturinave AMBIENTI SH.A, Njësia Operative Istog, ka parashtruar propozim për përmbarim kundër debitorit Sh. (V.) B. nga Fsh. T. Komuna e Istogut për pagesën e borxhit ne emër të borxhit për bartjen e mbeturinave për periudhën kohore 06.01.2011 e gjer me 28.02.2021, ne shume totale prej 407.60 €, të gjitha këto në afat 7 ditor në të kundërtën, të bllokohen llogaritë bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjete në llogari të bëhet regjistrimi, sekuestrimi, vlerësimi dhe shitja e sendeve të

luajtshme dhe të pa luajtshme e mjetet e mbledhura të derdhen në llogari të kreditorit, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përmbarim të dt. 20.04.2021.

Organi përmbarues me Urdhrin për Lejimin e Përmbarimit P.nr.114/2021, i dt: 20.04.2021, ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori Sh. (V.) B. nga Fsh. T. Komuna e Istogut brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim me shkrim, kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit, me kërkesë që të anulohet i njëjti urdhër si i pa bazuar me arsyetimin se borxhi për periudhën kohore 01.06.2011 e deri me 28.02.2020 është parashkruar në kuptim të nenit 360 par. 1 të LMD-së, kurse për periudhën kohore 28.02.2020-28.02.2021 në shumë prej 55.080 € pajtohem me borxhin që ta paguaj.

Kreditori, është njoftuar me prapësimin e debitorit si dhe me mundësin e parashtrimit të përgjigjes, ku me dt. 12.05.2021 përmes parashtresës ka ushtruar përgjigje në prapsim, me kërkesë që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar dhe të vërtetohet urdhri përmbarimor me arsyetimin se prapësimi i debitorit nuk i përmban asnjë nga shkaqet që parashihen në nenin 71 të LPP-së, po ashtu deklarimet e debitorit rreth parashkrimit janë në kundërshtim me pagesat e bëra të cilat pagesa e dëshmojnë se i njëjti e ka pranuar borxhin.

Gjykata Themelore në Pejë – Dega Istog, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se të njëjtit është i bazuar pjesërisht. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit pjesërisht tregojnë shkaqe sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohej përmbarimi i lejuar nga përmbaruesi privat

Gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të cilat gjenden në lëndë, si dhe pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit në prapësimin e parashtruar kur thirret në atë se borxhi i kërkuar nga kreditori është parashkruar konform nenit 360 të LMD-së, për të njëjtat pretendime gjykata gjeti se janë pjesërisht të bazuara, për faktin se i tërë borxhi me të cilin ngarkohet debitori Sh. (V.) B. nga Fsh. T. Komuna e Istogut për periudhën kohore 01.06.2011 e gjer me 31.12.2019, është borxh i parashkruar, konform nenit 360 par.1, për faktin se edhe pse debitori nga transaksioni i kreditorit gjatë kësaj periudhe shihet se ka bërë disa pagesa paushallë, mirëpo nuk ka dëshmi se këto pagesa a janë bërë në emër të borxhit paraprak apo në emër të faturave për muajt vijues, dhe se me vet faktin se ndërmjet kreditorit dhe debitorit nuk ka ekzistuar paraprakisht një marrëveshje për ri programim eventuale të borxhit, këto pagesa nuk e kanë bërë ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit, konform nenit 368 të LMD-së.

Pretendimet e kreditorit se pagesat deshmojnë se debitori e ka pranuar borxhin, gjykata konstaton se në rastin konkret pagesa e debitorit nuk hynë në kategorinë e pagesës të kësteve të cekur më lartë pasi kësti konsiderohet ndarje e borxhit në periudha të caktuara mujore apo më gjatë, ku borxhi i përgjithshëm ndahet në pjesë më të vogla për pagesë për një periudhë të caktuar. Pagesë e këstit do të mund të llogaritej nëse do të ekzistonte një marrëveshje në mes të kreditorit dhe debitorit, qoftë për ri programim të borxhit apo për pagesë të borxhit total të ndarë në këste, ndërsa këto as sesi nuk i atribuohet pagesave të debitorit, sepse edhe pse kemi borxh të akumuluar nga faturat mujore siç pretendon kreditori nuk kemi marrëveshje për ndarje me këste në mes të palëve, dhe pa një marrëveshje të tillë pagesat nuk trajtohen këste e as pranim i borxhit e as ndërprerje e parashkrimit.

Dispozita ligjore qartë e përcakton dhe nuk e cek faturën e as shumën më të madhe sesa fatura sepse pala gjatë pagesës ka mundësi të paguaj më tepër sesa ka borxh dhe ajo i llogaritet si avans për muajin tjetër, por assesi kjo nuk llogaritet këste.

Interpretimi i Gjykatës në raport me dispozitën e cituar më lartë është se pa marrëveshje të kreditorit dhe debitorit për pagesën e borxhit me këste, pagesat e kohëpaskohshme assesi nuk mund të trajtohen apo konsiderohen si këste në vetvete.

Duke marrë për bazë se pagesa e debitorit nuk hynë në kategorinë e pagesave të kësteve për ndërprerje të parashkrimit, këto pagesa i janë llogaritur debitorit në shumën e periudhës së kërkuar dhe pas zbritjeve së kësaj pagese nga shuma e borxhit të kërkuar, pjesa tjetër i mbetet debitorit për pagesë pasi e njëjta nuk është e parashkruar, krejt kjo konform dispozitave të cekura më lartë, se kur fillon afati i parashkrimit të rrjedh.

Se pagesat e kohëpaskohshme nuk e ndërprejnë parashkrimin ky fakt vërtetohet edhe në qëndrimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, referuar vendimeve të sajë.

Sa i përket borxhit për periudhën kohore 27.01.2020 e gjer me 28.02.2021, gjykata, gjeti se i njëjti borxh është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim të borxhit të kreditorit, në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, referuar nenit 360, par.2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077), parashihet që afati i parashkrimit për çdo kërkesë të arritur gjatë një viti, fillon të rrjedhë në fundin e atij viti, e që në rastin konkret për të gjitha kërkesat e arritura në vitin 2020, afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë me 01.01.2021, dhe në rastin konkret nuk kemi kalim të afatit të parashkrimit, për faktin se kreditori, propozimin për përmbarim e ka parashtruar me datën 20.04.2021, me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit, konform nenit 369 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077).

Duke u bazuar në nenin 17 të LPP-së, gjykata përshtatshëmish aplikoj dispozitat ligjore Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve.

Prandaj nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 3, 29 par.1.2, 1.3, 38, 69, 71, 73 par 3 të LPP-së (Ligjit për Procedure Përmbartimore), në lidhje me nenin 360 par.1 dhe 2, 368 dhe 369 të LMD-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG
PPP.nr.25/2021 dt: 17.06.2021

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga pranimi i të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa parashtrohet përmes kësaj gjykate.